



This programme is funded
by the European Union



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Korçë

2017

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH) dhe Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (RrFGSh), në kuadrin e projektit “Ndërtimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të lidhura me reduktimin e dhunës në baza gjinore dhe dhunës në familje të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020”. Projekti zbatohet nga QAGJZH dhe RrFGSh ne kuadër të programit rajonal kundër dhunes ndaj grave në Ballkanin Perendimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë’, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të **Komisionit Evropian**. Programi synon krijimin e një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për të mundësuar ulje të fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri.

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe Rrjetit të Fuqizimit Të Gruas në Shqipëri, dhe nuk reflekton opinionin e Komisionit Evropian dhe UN Women.

Autorët

Megi Llubani

Mirela Arqimandriti

Etleva Tare

Megi Zylali

Tabela e përmbajtjes

SHKURTIME	4
HYRJE	5
METODOLOGJIA	7
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR BASHKINË E KORÇËS	9
MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020	10
GJETJET KRYESORE	10
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE	12
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2017	14
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	14
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	15
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN E TYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA	20
REKOMANDIME NË BAZË TË MONITORIMIT TË PUNËS KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE NË BASHKINË KORÇË	21
ANEKSE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
ANEKSI 1- DETYRAT E KOORDINATORIT PËR BARAZI GJINORE DHE KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
ANEKSI 2- DETYRAT E TË GJITHË ANËTARËVE QË KANË NËSHKRUAR MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT SI PJESTARË TË MEKANIZMIT TË RREFERIMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

Lista e tabelave

Tabela 1. Profili i Bashkisë Korçë.....	9
Tabela 2. Të dhëna demografike mbi popullsinë e Korçës	10
Tabela 3. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Policisë Bashkia Korçë	13
Tabela 4. Raportimet e dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Korçë	13
Tabela 5. Raste të trajtura me Ndihmë ekonomike në Bashkinë Korçë si kategori e veçantë e pajisur me UM/UMB.....	13
Tabela 6. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre.....	15
Tabela 7. Numri i mbledhjeve të Grupi Teknik Ndërdisciplinor sipas viteve.....	19
Tabela 8. Numri i mbledhjeve të Komitetit Drejtues sipas viteve.....	19
Tabela 9. Koordinator vendor kundër Dhunës me bazë Gjinore DhBGj.....	19
Tabela 10. Grupi Teknik Ndërdisciplinor e Bashkisë Korçë	19
Tabela 11. Dhunuesit në sistemin gjyqësor Korçë	20

Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
DhKG	Dhunë ndaj Grave
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
IZhA	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
KONVENTA CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MD	Ministria e Drejtësisë
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MRR	Mekanizmi i Referimit të Rasteve
(MMSR)MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGj	Nëpunës i Barazisë Gjinore
NjVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizatë Joqeveritare (Jo-fitimprurëse)
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PShSh	Policia e Shtetit Shqiptar
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QZhK “Sot për të Ardhmen”	Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”
REVALB	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
ShGPS	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Hyrje

Projekti “Ndërtimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OShC-ve) për të monitoruar zbatimin e aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020” në lidhje me reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje gjatë periudhës Nëntor 2017 – Tetor 2019. Në Shqipëri projekti zbatohet nga QAGjZh dhe RrFGSh në kuadër të programit rajonal kundër dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ‘Zbatojmë Standartet, Ndryshojmë Mendësitë’, të zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të Komisionit Evropian. Njësitë administrative të përfshira në monitorim janë bashkitë e Tiranës, Korçës, Shkodrës, Vlorës, Elbasanit, Durrësit. Njëkohësisht, po në kuadër të zbatimit të Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020, monitorimi ndërmerret edhe për aktivitetet e planifikuara në nivel kombëtar.

Qëllimi i projektit është krijimi i një mjedisi legjislativ dhe politik të përshtatshëm për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Procesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2010-2020 është duke u zhvilluar përgjatë periudhës Mars 2018 - Shtator 2019. Aktivitetet në nivel qendror do të monitorohen nga QAGjZh dhe RrFGSh përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin e aktiviteteve të PVK 2016-2020 nga të gjitha institucionet përgjegjëse, ndërsa aktivitetet në nivel vendor do të monitorohen nga organizatat lokale, disa prej tyre anëtare të RrFGSh.

Arritjet e pritshme: 1) OShC-të kanë kapacitetet e nevojshme për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020; 2) Procesi i monitorimit nga OShC-të përfundohet me sukses për vitin 2018 dhe 2019; 3) Realizimi i procesit të advokimit nga OShC-të, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e ka nisur punën me organizimin e seancave informuese me OShC-të në 6 bashkitë e synuara, duke vijuar më pas me zhvillimin e një manuali/udhëzuesi për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, për përdorim gjatë trajnimeve me OShC-të lokale që do të monitorojnë Qëllimin Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020. Përveç manualit u hartuan disa skeda monitoruese të cilat u ndërtuan bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020. Procesi i monitorimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020 është duke u realizuar në të gjashtë bashkitë, si dhe në nivel qendror, për 2 vite me radhë (2018 dhe 2019). Pjesë e procesit monitorues janë edhe aktivitetet e planit të veprimit të zbatuara gjatë vitit 2017. Të dhënat e mbledhura nga monitoruesit do të analizohen dhe në bazë të kësaj analize do të hartohen raportet (2018, 2019) me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Pas publikimit të raporteve, do të organizohen tryeza të rrumbullakëta në çdo qark lidhur me gjetjet e procesit monitorues, pasuar nga takime advokuese me instancat vendimmarrëse e politikëbërëse. Paralelisht, do të bashkëpunohet me profesionistë të medias për të raportuar periodikisht gjetjet dhe rekomandimet e dala përfshirë informimin në mediat sociale, por edhe për të ngritur kapacitetet e tyre rreth raportimit të ndjeshëm gjinor.

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2017.

Raporti do të pasurohet më tej me gjetjet e raportimeve për vitet 2018 dhe 2019.

Rreth organizatave zbatuese

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë

nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për ti dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;
- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri - RrFGSh është një organizatë jo-fitimprurëse, e krijuar në vitin 2009, që punon në fushën e të drejtave të grave dhe vajzave. Qëllimi kryesor i këtij rrjeti është fuqizimi social, ekonomik, kulturor dhe politik i gruas shqiptare. Rrjeti përbëhet nga 10 organizata të cilat shtrihen në të gjithë territorin e Shqipërisë, nga veriu në jug:

- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë
- Forumi i Gruas Elbasan
- Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë
- Shoqata e Grave me Probleme Sociale
- Shoqata Unë Gruaja, Pogradec
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë
- Shoqata Agritra Vizion, Peshkopi
- Shoqata Gruaja tek Gruaja, Shkodër
- Shoqata Jona, Sarandë
- Qendra për Nisma Ligjore e Qytetare, Tiranë

Për bashkinë e Durrësit raporti u hartua me ndihmën e eksperteve Rrezarta Agolli dhe Bajana Cevoli të Shoqatës së Grave me Probleme Sociale (ShGPS). Ndërsa monitorimi i mbledhjeve të mekanizmit të referimit u krye nga dy eksperte të pavarura Erisilda Shpata dhe Greta Çela.

ShGPS është një organizatë jo-fitimprurëse, e themeluar në vitin 1999, e cila operon në Qarkun e Durrësit. Ajo ka si qëllim promovimin e barazisë gjinore në shoqëri si dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të marxhinalizuara të grave në këtë Qark. Dhuna në familje, barazia gjinore, pjesëmarrja aktive e gruas në vendim-marrje, si dhe integrimi i komuniteteve të zonave informale në jetën social-kulturore të qytetit janë çështjet kryesore në fokus të punës së kësaj organizate.

Për më shumë se një dekadë, ShGPS ka ofruar një gamë të gjërë shërbimesh për grupet vulnerabël të grave të këtij Qarku, shërbime të cilat kanë konsistuar në: shërbime psiko-sociale, shërbime ligjore, shërbime mjekësore si dhe në informim dhe ndërgjegjësim.

Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktime të dhunës në familje.

Nërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planin e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatohet një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

Metodologjia

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Dy monitoruese u përzgjodhën për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën Janar – Dhjetor 2017 dhe fillim vitin 2018.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

1. Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njësuar koordinatorin vendor të dhunës pranë bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.
2. Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:
 - Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
 - Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
 - Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
 - Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjësuese të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbeshtetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rastet e dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikat për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t'i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkitë në nivel lokal dhe MShMS në nivel qendror në adresën WWW.revalb.org

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t'u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; Kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.

Të dhëna të përgjithshme për Bashkinë e Korçës

Bashkia Korçë kufizohet në veri me bashkinë Maliq, në lindje me bashkinë Devoll, në perëndim me bashkinë Skrapar, ndërsa në jug me bashkinë Kolonjë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Korçës. Bashkia përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Korçë, Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë.

Figura 1. Harta administrative e Bashkisë Korçë



Burimi: UNDP. STAR 2. Qeverisja Vendore – Vetë vlerësime e perceptime, Bashkia Korçë

Bashkia Korçë ka një popullsi prej 120,966 banorë sipas Regjistrit të Gjendjes Civile dhe 75,994 banorë sipas INSTAT, Census 2011, ndërsa numri i familjeve është 41,952. Bashkia e re ka nën administrimin e saj 1 qytet dhe 62 fshatra.

Tabela 1. Profili i Bashkisë Korçë

Bashkia	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative	Fshatrat në përbërje
Korçë	Qyteti Korçë	Korçë	Qyteti Korçë
		Qëndër Bulgarec	Bulgarec, Lumalas, Biranj, Melcan, Porodinë, Dishnicë, Shamoll, Belorta, Kuç i Zi, Barç, Çiflig, Malavec, Neviçisht
		Voskop	Voskop, Dërsnik, Polen, Vinçan, Goskovë lart, Goskovë poshtë, Damjanec
		Voskopojë	Voskopojë, Shipskë, Krushovë, Gjonmadh, Lavdar
		Lekas	Lekas, Marjan, Gjonbabas, Gurmuja, Shkozan, Xerje, Tudas, Gjergjevicë, Lavdar Brozdovec, Mazrek, Poponivë
		Vithkuq	Vithkuq, Leshnje, Gjanc, Lubonjë, Rehovë, Roshanj, Trebickë, Grabockë, Treskë, Stratobërdh, Panarit, Shtyllë, Cemicë
		Mollaj	Mollaj, Floq, Pulahë, Ujë Bardhë, Kamenicë
		Drenovë	Drenovë, Mborje, Boboshticë, Moravë, Qatrom, Ravonik, Turan, Dardhë

Burimi: UNDP. STAR 2. Qeverisja Vendore – Vetë vlerësime e perceptime, Bashkia Korçë

Bashkia Korçë përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Korçë, Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut të Korçës.

Tabela 2. Të dhëna demografike mbi popullsinë e Korçës

Njësitë administrative	Numri i fshatrave	Numri i Familjeve	Popullsia sipas Regjistrimit Civil 2016	Popullsia sipas Census 2011
			Gjithsej	Gjithsej
Korçë	-	29,534	87,142	51,152
Qendër Bulgarec	13	3,953	14,055	9,022
Voskop	7	1,632	5,999	3,832
Voskopojë	5	1,107	5,999	1,058
Lekas	12			392
Vithkuq	13	2,522	9,081	1,519
Mollaj	5			3,438
Drenovë	8	3,204	1,026	5,581
Totali				

Burimi: UNDP. STAR 2. Qeverisja Vendore – Vetë vlerësime e perceptime, Bashkia Korçë

Bashkia Korçë ka të përcaktuar një fond prej 38,335,324 lekë për ndihmën ekonomike nga ku përfitojnë 966 familje në total. Ndërsa për fondin e paaftësisë bashkia ka përcaktuar fondin prej 231,279,477 lekë ku përfitues janë 1,821 persona.

I gjithë territori i Korçës mbulohet nga 7 institucione arsimore: 45 kopshte, 6 parashkollorë, 52 shkolla 9-vjeçare dhe 10 shkolla të mesme.

Në zonën e Korçës për të përmbushur nevojat e komunitetit operojnë 17 qendra shëndetësore dhe 2 ambulanca. Përsa i përket kapaciteteve njerëzore, siç vihet re dhe në tabelën e mëposhtme të dhënat janë të pakta. Kështu, nga të dhënat e siguruar, Bashkia e Korçës numëron gjithsej 22 mjekë të përgjithshëm.

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2017. Raporti do të pasurohet më tej me gjetjet raportimeve për vitet 2018 dhe 2019.

Gjetjet kryesore

Në përgjithësi, Bashkia e Korçës ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për adresimin e dhunës me bazë gjinore si edhe dhunën në familje, si nga ana e zbatimit të legjislacionit dhe planeve të veprimit ashtu edhe përmes aktiviteteve dhe iniciativave të ndërmarra përgjatë vitit 2017 në përmbushje të Strategjisë së Baraisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit:

- Bashkia e Korcës ka një strukturë të qendrueshme të mekanizmit të referimit, që është ngritur që prej vitit 2010. MKR Korçë ka trajtuar qindra raste që nga themelimi dhe ka një bashkëpunim shumë të mirë me aktorët e tjerë të mekanizmit. Gjithashtu përzgjidhet si rast suksesi apo për shkëmbime eksperiencash dhe trajnim për bashkitë e tjera të cilat e kanë vendosur këtë mekanizëm rishtazi.
- Në përputhje me objektivin 3.1 për rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet rreth rëndësisë së luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunën në familje Bashkia e Korcës ka zhvilluar një sërë aktivitete dhe fushatash me grupe të ndryshme, përfshirë nxënës, studentë, prindër, qytetarë aktivë etj. Fondi i alokuar për aktivitete të ndryshme për dhunën me bazë gjinore në vitin 2017 ka qenë 136900 lekë.
- Bashkia Korçë është një nga bashkitë më të mira përsa i përket përditësimit të sistemin online REVALB.
- Në vitin 2017, bashkia e Korcës përveç fondit për aktivitete kundër dhunës, parashikon pagën e NBGj.
- Bashkia Korçë ka krijuar një plani veprimi për barazinë gjinore në nivel lokal.
- Bashkia Korçë është e ftuar në aktivitete të ndryshme në nivel kombëtar si edhe jashtë Shqipërisë për të ndarë eksperiencë në lidhje me funksionimin e MKR në luftë kundër dhunës me bazë gjinore.
- Hapja e strehëzës së emergjencës për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, në vitin 2016, është një hap pozitiv për adresimin e fenomenit në këtë bashki.
- Bashkia Korçë ka vënë në dispozicion në vitin 2017 dy projekte të financuara nga buxheti i saj, për të asistuar rastet e dhunës në familje dhe për sensibilizimin qytetar ndaj fenomenit. Këto dy projekte janë: “Strehëza emergjente për viktimat e dhunës në familje” dhe “Ndërgjegjësimi i komunitetit rural nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje”. Buxheti i vënë në dispozicion për këto dy projekte është 503.000 lekë gjithsej.
- Tre prej organizatave kryesore që veprojnë në fushën e dhunës me bazë gjinore në bashkinë e Korcës dhe që shpesh plotësojnë shërbimet që bashkia nuk ka mundësi të ofrojë janë organizata fetare, specifikisht Misioni Emanuel, Fondacioni Kenedi dhe Jezu Krishti për Ballkanin. Përtej pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta vërehet se nuk ka koordinim ndërmjet bashkisë dhe këtyre organizatave për përmbushjen e objektivit 3.1.6 për rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të komuniteteve fetare për shpërndarjen e mesazheve sensibilizuese kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Sipas informacioneve të mbledhura këto organizata fetare nuk i referohen specifikisht dhunës në familje në shërbesat e tyre fetare.
- Shërbimi i provës në bashkinë e Korcës gjatë vitit 2017 ka patur të punësuar vetëm drejtorin e shërbimit të provës. Kjo e vështirëson monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave si edhe vlerësimin e përpjekjeve për përmirësimin e rolit të shërbimit të provës në identifikimin e nevojave për referimin e rasteve konkrete të dhunës në varësi të formës së dhunës së ushtruar e në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas objektivit 3.3.6. Ky institucion rrallë përfaqësohet në mbledhjet e GTN-së.
- Bashkia Korçë nuk ka mundësi të japë shërbim psikologjik falas për viktimat e dhunës në familje. Institucioni nuk mundëson dot konsulencë juridike falas për çdo rast. Këto dy shërbime jepen në partneritet dhe nuk janë të qendrueshme. Në shumicën e rasteve NBGj së bashku me koleget e saj, detyrohet të përpilojë kërkesë-paditë për zgjidhjen e martesës, apo për vendosjen e kujdestarisë së fëmijëve nga përfitueset. Konsulenca psikologjike dhe

juridike falas është dhënë në partneritet me organizata brenda dhe jashtë qytetit si me organizatat TLAS, Nisma Ligjore Qytetare, Unë gruaja etj.

- Një prej mangësive më të mëdha të vëzhguara gjatë procesit të monitorimit është përmbushja e objektivit 3.2.7 mbi zgjerimin e gamës së shërbimeve mbështetëse të specializuara në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambollit si edhe shtrirja e tyre në mbarë vendin. Sikurse është vënë në dukje edhe më sipër burimet financiare dhe njerëzore janë të pamjaftueshme për shtimin e shërbimeve mbështetëse dhe fokusimin tek kategori të caktuara si personat me aftësi të kufizuara, personat LGBTI etj. Nga bashkia e Korcës raportohet se nuk ka as shërbime të tilla dhe as shtesa në personel për të ofruar këto shërbime. Më shpesh këto shërbime ofrohen nga organizata lokale të shoqërisë civile. Për rrjedhojë në të ardhmen fokus më i madh duhet vendosur tek rritja e kapaciteteve të bashkisë për të ofruar shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje

Ky raport bazohet në monitorimin e veprimtarisë së Bashkisë Korçë për periudhën Janar-Dhjetor 2017 në zbatimin e Qëllimit Strategjik 3 të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore “Reduktimi i Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje”. Monitorimi është kryer përmes ndjekjes së punës së Bashkisë Korçë, mbledhjes së informacioneve dhe materialeve përkatëse nga zyrat përgjegjëse për implementimin e strategjisë si edhe intervista me përfaqësues të pushtetit vendor. Secili prej objektivave specifike të qëllimit strategjik 3 është analizuar dhe raporti është strukturuar në bazë të këtyre objektivave.

Në vitin 2017 qarku i Korcës renditej i katërti për nga numri i grave që përjetojnë dhunë në familje, nga 12 qarqe në gjithë Republikën e Shqipërisë, duke zënë kështu 7.7% të totalit. Norma e raportimit të dhunës në familje në qarkun e Korcës është pak më e lartë se norma kombëtare, 23.8 denoncime për 10,000 banorë, krahasuar me 22.7 denoncime për 10,000 banorë për gjithë Republikën e Shqipërisë.¹

Në gjykatën e Korcës janë marrë 81 vendime për vitin 2017, prej të cilave 77.77% kanë pasur gra si palë paditëse. Në pothuajse 50% të të gjithë rasteve të referuara në gjykatë viktimat ka qenë bashkëshorte e dhunuesit, ndjekur nga 24.9% që kanë qenë fëmijë ose prindër. Në shumicën dërrmuese të rasteve gjykata e rrethit të Korcës, mbi 71%, ka lëshuar urdhëra të menjëhershëm të mbrojtjes. Prej të gjitha kërkesave referuar gjykatës për lëshimin e urdhërave, 24.69% janë pranuar, ndërsa shumica dërrmuese janë pushuar si çështje, mbi 65%. Prej këtyre, gjysma janë pushuar pasi nuk është paraqitur pala paditëse dhe gjysma pasi ka pasur heqje dorë për vijimin e rastit. Këto shifra ngrenë pikëpyetje mbi arsyet se përse ndodh një fenomen i tillë.²

¹ Burimi: INSTAT, Burra dhe gra 2018.

² RrFGSh, 2017. Gjetje nga monitorimi i vendimeve gjyqësore me objekt lëshimin e UM/UMM në gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër, Durrës, Elbasan, Pogradec, Vlorë, Korçë, Dibër, Elbasan.

Sipas tabelës më poshtë janë 140 raste të evidentuara të dhunës në familje në bashkinë Korçë nga të cilat 29 vepër penal sipas nenit 103/a me 12 autorë të arrestuar. Janë bërë 88 padi për urdhër mbrojtje nga të cilat 0 janë shkelur.

Tabela 3. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Policisë Bashkia Korçë

Dhuna në familje	
Raste te evidentuara	140
Vrasje raste	0
Viktima	0
Kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje	88
Shkelje Urdhër Mbrojtje	9
Vepër penale- Neni 130/a	29
Autorë të arrestuar	12
Autorë të ndaluar	1
Autorë të shpallur në kërkim	1
Autorë në gjendje të lire	15
Autorë të vetvlarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së shtetit

Tabela 4. Raportimet e dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Korçë

Të dhëna në lidhje me rastet e dhunës në familje	Viti 2017
Nr i rasteve të dhunës në familje	108
Nr. i rasteve të pajisur me UMM/UM	57
Nr.i rasteve pa UM	51

Burimi: Bashkia Korçë

Numri i grave dhe vajzave viktime të dhunës në marrëdhëniet familjare gjatë vitit 2017 ishte 91 viktime kundrejt 17 burrave viktime të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sipas të dhënave rreth 17 % e tyre vijnë nga komunitetet në nevojë.

Tabela 5. Raste të trajtura me Ndihmë ekonomike në Bashkinë Korçë si kategori e veçantë e pajisur me UM/UMB

Viti 2017	Raste/persona
Janar	2
Shkurt	2
Mars	4
Prill	4

Maj	4
Qershor	4
Korrik	4
Gusht	3
Shtator	2
Tetor	-
Nëntor	-
Dhjetor	4
Total	33

Burimi: Statistikat e Drejtorisë së Kujdesit Social

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2017

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Ndarja e roleve në shoqëri sipas gjinisë dhe mendësia patriarkale për pozicionin e gruas në Shqipëri është shpesh burim dhe justifikim për ushtrimin e dhunës ndaj gruas, veçanërisht në marrëdhëniet familjare. Për rrjedhojë ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar ushtrimin e dhunës ndaj gruas si fenomen i zakonshëm dhe pjesë normale e shoqërisë shqiptare përbën hap të parë e bazik, sikurse njihet edhe në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020.

Në bashkinë e Korçës janë bërë një numër përpjekjesh për të ndërgjegjësuar segmente të ndryshme të shoqërisë rreth rëndësisë së luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Kjo bëhet e qartë nga shpeshësia dhe numri i aktiviteteve organizuar nga bashkia.

Në vitin 2017 Bashkia e Korçës implementoi një projekt për rritjen e ndërgjegjësitimit qytetar, titulluar “Ndërgjegjësimi i komunitetit rural nëpërmejt aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje”.

Theks i vecantë është vendosur në rritjen e ndërgjegjësitimit përmes aktiviteteve shkollore të të rinjve në bashkinë e Korçës. Zyra Kundër Dhunës në Familje dhe Barazisë Gjinore ka organizuar në bashkëpunim me shërbimin psiko-social disa aktivitete me shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në zonat rurale dhe qytet. Në këto aktiviteti kanë marrë pjesë nxënës, prindër, mësues. Ata janë informuar mbi çështjet që lidhen me dhunën në familje, dhunën me bazë gjinore, si dhe konceptet e barazisë gjinore. Si materiale promocionale janë përdorur fletëpalosje, stativa, materiale filmike. Gjatë muajve nëntor e dhjetor janë organizuar aktivitete sensibilizuese intensive në shkollat e mesme të qytetit, në bashkëpunim me Shërbimin Psiko-Social të Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe Drejtorinë e Policisë. Tematika e këtyre takimeve sensibilizuese ishte t’i shpjegohej nxënësve dhe pjesëmarrësve se çfarë ndodh në një rast dhune, shërbimet që mundësohen dhe legjislacioni në fuqi.

Tre prej organizatave kryesore që veprojnë në fushën e dhunës me bazë gjinore në bashkinë e Korçës dhe që shpesh plotësojnë shërbimet që bashkia nuk ka mundësi të ofrojë janë organizata fetare, specifikuat Misioni Emanuel, Fondacioni Kenedi dhe Jezu Krishti për Ballkanin. Përtej

pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta nuk ka koordinim ndërmjet bashkisë dhe këtyre organizatave për përmbushjen e objektivit 3.1.6 për rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të komuniteteve fetare për shpërndarjen e mesazheve sensibilizuese kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Sipas informacioneve të mbledhura, këto organizata fetare nuk i referohen specifikisht dhunës në familje në shërbesat e tyre fetare. Për më tepër, përgjatë vitit 2017 nuk janë kryer trajnime të përfaqësuesve fetarë për adresimin e dhunës në familje, megjithëse të treja këto organizata fetare janë të përfshira në mënyrë aktive në ofrimin e shërbimeve dhe rritjen e ndërgjegjësimit për dhunën me bazë gjinore në bashkinë e Korçës. Më tepër përpjekje mund të bëhen për rritjen e koordinimit ndërmjet Zyrës Kundër Dhunës në Familje dhe Barazisë Gjinore dhe organizatave lokale të shoqërisë civile, sidomos organizatat fetare të përmendura më sipër, në mënyrë që të krijohet një rrjet i përbashkët dhe i sinkronizuar për luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Korçë ka bërë nënshkrimin e “Kartës Europiane për barazi të grave dhe burrave në jetën vendore” që prej vitit 2016. Ky është një angazhim në përdorimin e përgjegjësive dhe partneriteve për arritjen e një barazie më të madhe për banorët e Bashkisë Korçë. Bashkia e Korçës është gjithashtu në hapat e hartimit të një **plani veprimi të barazisë gjinore**. Është kërkuar bashkëpunimi i të gjitha institucioneve dhe organizatave me qëllim mbledhjen e perspektivave të ndryshme në lidhje me aspekte të barazisë gjinore si për shembull strehimi, siguria, punësimi apo shëndeti.

Tabela 6. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Data	Ora	Vendi	Aktiviteti	Intitucioni/Organizata
17.03.2017	Ora 11:00	Shk.”Naum Veqilharxhi”	Dhuna në familje dhe konceptet e barazisë gjinore	Bashkia Korçëe, Shërbimi psiko social i shkollës
22.07.2017	Ora 13:00	Qendra Multifunksionale	“Roli i gruas në familje nga aspekti gjinor”	Bashkia Korçë, Misioni Emanuel
24.11.2017	Ora 12:00	Korçë	Aktivitet sensibilizues në qytet në disa zona	Bashkia Korçëe Institucionet Rajonale
30.11.2017	Ora 11:00	Drenovë	C’është dhuna në familje. Aspektet ligjore dhe shërbimet	Bashkia Korçëe, Nja Drenovë, Shërbimi psiko-social i shkollës

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Funksionimi i mekanizmit të referimit rezulton të jetë një nga pikat më të forta në zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore nga ana e bashkisë së Korçës. Në bazë të të dhënave të mbledhura nga bashkia dhe rezultatet e monitorimit të punës së bashkisë, rezulton se bashkia Korçë ka kapacitetet e duhura për të përdorur mekanizmin e referimit dhe ofrimin e eksperiencave të saj për bashki të tjera të cilat i kanë vendosur këto mekanizma rishtazi.

Përgjatë vitit 2017 janë organizuar 4 mbledhje të zakonshme të Grupit Teknik Ndërdisciplinar, konkretisht në datë 2 shkurt, 27 Prill, 11 tetor dhe 7 dhjetor 2017. Të pranishëm kanë qënë të gjitha institucionet rajonale përveç Zyrës së Përmbartimit dhe Prokurorisë. Mbledhja e radhës e Komitetit Drejtues të bashkisë u organizua në 13 Dhjetor 2017. Në të merrnin pjesë titullarët e institucioneve pjesë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, Fondacionet Kenedi dhe Jezus Krishti për Ballkanin, ky i fundit është partner në shërbimin e strehëzës emergjente. Gjatë vitit 2017 ka pasur 8 raste të referuara nga mini-ekipet teknike të Njësisve Administrative të trajtuara në mbledhjet e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR)-së. Nga zonat rurale janë regjistruar 10 raste të dhunës në familje të denoncuara në komisarariat.

Bashkia Korçë ka një numër pa pagesë 0800 3434 për denoncimin e rasteve të dhunës në familje, por që jep shërbim 5 ditë të javës gjatë orarit zyrtar. Gjatë vitit 2017 ka pasur vetëm dy telefonata për të marrë informacion dhe për t'u qartësuar mbi shërbimet. Përgjegjës për këtë shërbim është koordinatori vendor KDHF që kryhen njëkohësisht dhe detyrat e tjera parashikuar në ligj. Është fakt prej disa vitesh, panvarësisht promovimit të herë pas hershëm të numrit pa pagesë, si shërbim shtesë ndaj qytetarit, ata preferojnë të denoncojnë në 99% të rasteve në komisarariat dhe tek zyra kundër dhunës në familje.

Gjatë vitit 2017, janë ndjekur 20 raste, duke i asistuar në përpilimin e kërkesë padive për çështje divorci, kujdestarie dhe konsulencë mbi urdhrat e mbrojtjes. Në rastet e fëmijëve të dhunuar Bashkia Korçë ka ndjekur çështjet në gjykatë në 100% të rasteve por bashkia Korçë ndjen vështirësi në pagimin e akteve noteriale apo tarifave të tjera lidhur me veprime juridike, për viktimat e dhunës me bazë gjinore, të cilat nuk kanë mundësi pagese. NBGj i duhet të bëjë përpjekje të mëdha për të siguruar shlyerjen e këtyre tarifave nëpërmjet bashkëpunimit me OJF-të-të, të cilat jo gjithmonë e kanë mundësinë për asistim.

Në datë 27 Prill 2017 është organizuar një takim me delegacionin e GREVIO shoqëruar nga përfaqësues të MMSR, mbi monitorimin e zbatimit të "Koventës së Stambollit". Në takim mori pjesë z. Filo, Kryetar i Bashkisë Korçë, i cili foli për hapat dhe nismat e ndërmarra nga Bashkia Korçë në luftën kundër dhunës në familje. Ai përmendi bashkëpunim ndërinstucional, i cili është formalizuar nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit. Ngritjen dhe mirëfunksionimin e ekipit multidisiplinar dhe më pas zgjerimi i tij me mini - ekipet teknike në zonat rurale, nëpërmjet një projekti pilot. Në fjalimin e tij, ai përmendi shërbimet e përfshira në buxhet me fondet e Bashkisë. Në pjesën e dytë të takimit, ishin të pranishme të gjitha institucionet dhe organizatat pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit, përveç Zyrës Përmbartimit. Gjatë takimit u trajtua një rast i menaxhuar së fundmi nga MKR, Korçë për treguar më qartë mënyrën e referimit, koordinimit dhe menaxhimit të rastit.

Është bërë tashmë traditë që Bashkia Korçë mirëpret për shkëmbim eksperience me mekanizmat referues nga gjithë vendi, por edhe jashtë tij, si psh. MKR e Bashkisë Durrës, Përmet, Sarandë, Kolonjë, Himarë edhe atë të Prishtinës. Në 7 dhjetor, MKR, Bashkia Korçë ka mirëpritur për shkëmbim eksperiencë MKR e Bashkisë Himarë, një mekanizëm i krijuar rishtazi. Pjesëmarrja ishte e kënaqshme. Ekipi i Bashkisë Korçë u tregoi kolegëve të Himarës sesi funksionon duke ua bërë konkret procesin nëpërmjet shembujve realë. Përfaqësuesit e Policisë Korçë folën për procedurën standarte të menaxhimit të rasteve të dhunës nga punonjësit e policisë. Ata u ndalën konkretisht në shifrat e vitit të fundit, duke dhënë një pasqyrë të situatës. Të gjithë anëtarët e MKR folën për detyrat dhe mënyrën sesi kontribuojnë në zgjidhjen e rastit. Gjatë këtij aktiviteti u realizua dhe mbledhje e fundit për vitin 2017 e ekipit multidisiplinar KDHF duke u treguar konkretisht kolegëve të Himarës sesi zhvillohen mbledhjet e MKR nga Bashkia Korçë.

Që prej vitit 2010 bashkia e Korçës ka krijuar pozicionin e koordinatorit vendor përgjegjës për luftën kundër dhunës në familje. Në datën 10 Maj 2010 është formalizuar mekanizmi i referimit në Bashkinë Korçë. Ky pozicion ekziston brenda strukturës organizative të bashkisë së Korçës dhe përfshihet në statusin e nëpunësit civil, duke pasur kështu edhe detajim të detyrave dhe përgjegjësi. Sipas të dhënave të përfuara nga bashkia ky pozicion nuk ka role të tjera në bashki, duke lejuar kështu përqendrim të plotë tek lufta kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Detyrat e këtij pozicioni janë performuar në 7 vitet e fundit nga i njëjti person, duke qenë kështu ndër bashkitë e para që e kanë krijuar këtë post për adresimin e dhunës në familje dhe me mbajtja e këtij roli nga një person i vetëm përgjatë të gjithë këtyre viteve, qysh prej krijimit të tij ka krijuar kështu kujtesë institucionale dhe qëndrueshmëri në punën e kryer. Koordinatorit vendor ka marrë pjesë në disa trajnime mbi dhunën në familje dhe ështjet gjinore, duke përfshirë këtu edhe viktimat e dhunës seksuale. Më specifikisht është zhvilluar një trajnim në datat 23-24 tetor 2017 "Forcimi i ekipit multidisiplinar kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje" zhvilluar nga PNUD dhe UNFPA. Më tej në datat 22-29 Prill është zhvilluar "Trajnim mbi shërbimet për viktimat e dhunës seksuale.(PNUD) 7 qershor 2018, Qendra Altri" T drejtat e viktimave të vepreë penale" ku përmendeshin përveç viktimave të trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje. Koordinatorit vendor nuk është në dijeni të ekzistencës së një moduli të unifikuar të Shkollë Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) rreth trajnimeve të zhvilluara.

Hedhja dhe përditësimi i të dhënave për rastet e dhunës në familje në sistemin on-line bëhet në mënyrë të rregullt nga koordinatori vendor. Të dhënat hidhen dhe përditësohen çdo ditë nga personi përgjegjës i cili ka marrë edhe trajnimin e nevojshëm për përdorimin e databazës. Cdo muaj personi përgjegjës për sistemin online përditëson policinë si pritësin e parë të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Bashkia e Korçës nuk ka nënshkruar një protokoll specifik me policinë për ndarjen e të dhënave, megjithatë raportohet se ekziston një marrëveshje bashkëpunimi institucionale, që ndryshon sa herë është e nevojshme në shërbim të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet tyre. Përgjatë vitit 2017 janë asistuar 108 raste nga MKR Korçë, nga te cilat 91 femra dhe 17 meshkuj, 57 prej tyre janë shoqëruar me Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje/ Urdhër Mbrojtjeje (UMM/UM). Rezulton se grup-mosha më e prekur nga dhuna është 30-40 vjeç, marrëdhënia më problematike është ajo e partnerëve intim 48.7% e rasteve. Cdo tre muaj koordinatori i bashkisë raporton pranë të dhënat e sistemit tek anëtarët e tjerë të MKR-së. Përgjatë monitorimit nuk janë vënë re probleme të përdorimit të sistemit online.

Bashkia Korçë ka vënë në dispozicion dy projekte të financuara nga buxheti i saj, për të asistuar rastet e dhunës në familje dhe për sensibilizimin qytetar ndaj fenomenit. Këto dy projekte janë: “Strehëza emergjente për viktimat e dhunës në familje” dhe “Ndërgjegjësimi i komunitetit rural nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje”. Buxheti i vënë në dispozicion për këto dy projekte është 503.000 lekë gjithsej. Strehëza emergjente ka dhënë shërbim gjatë gjithë vitit 2017. Në këtë periudhë dymbëdhjetë mujore janë strehuar 7(shtatë) përfitues gjithsej: 3(tre) gra, 1 (një) mashkull, djali i njëres prej përfitueseve dhe 3(tre) fëmijë të shoqëruar nga nënat e tyre. Në bazë të monitorimit shërbimi i ofruar nga strehëza emergjente ka ende nevojë për shumë përmirësime, veçanërisht në shërbimet që ofrohen. Sikurse ndodh edhe në nivel qendror dhe në bashki të tjera, shumë prej shërbimeve të ofruara për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje nuk do të ishin të mundshme pa ndërhyrjen dhe angazhimin e organizatave të shoqërisë civile.

Një prej mangësive më të mëdha të vëzhguara gjatë procesit të monitorimit është përmbushja e objektivit 3.2.7 mbi zgjerimin e gamës së shërbimeve mbështetëse të specializuara në përputhje me kërkesat e Konventës së Stambëllit si edhe shtrirja e tyre në mbarë vendin. Sikurse është vënë në dukje edhe më sipër burimet financiare dhe njerëzore janë të pamjaftueshme për shtimin e shërbimeve mbështetëse dhe fokusimin tek kategori të caktuara si personat me aftësi të kufizuara, personat LGBTI etj. Nga bashkia e Korçës raportohet se nuk ka shërbime të tilla dhe shtesa në personel për këto shërbime. Më shpesh këto shërbime ofrohen nga organizata lokale të shoqërisë civile. Për rrjedhojë në të ardhmen fokus më i madh duhet vendosur tek rritja e kapaciteteve të bashkisë për të ofruar shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Drejtoria e Kujdesit Social, ku bën pjesë dhe Zyra Kundër Dhunës në Familje dhe Barazisë Gjinore, ofron shërbime të perkujdesit të familjeve, fëmijëve dhe kategorive në nevojë për të realizuar përmirësimin dhe ridimensionimin e problemeve sociale. Një hapësirë e veçantë u jepet viktimave të dhunës në familje duke i asistuar me shërbime si strehimi emergjent, bonusi i strehimit, ndihma e drejtpërdrejtë në ushqim dhe veshmbathje, shërbim psiko-social, linjë këshillimi pa pagesë, ndihmë juridike falas në bashkëpunim me partnerë të tjerë, ndihma ekonomike për viktimat e dhunës në familje të pajisura me urdhër mbrojtje.

Për Drejtorinë e Kujdesit Social është një sfidë dhënia e shërbimit të plotë dhe cilësor për të mbijetuarit e dhunës në familje, në rastet shumë të vështira dhe kur ka mungesë shërbimesh të specializuara. Është mjaft e vështirë dhënia e shërbimit ndaj personave me aftësi të kufizuara, përfshi këtu probleme të shëndetit mendor apo personave me aftësi të kufizuar, kjo për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe mungesës së shërbimeve për këtë kategori qytetarësh. Megjithatë, raste suksesi janë shënuar prej bashkëpunimit me Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor dhe bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile që gjenden brenda dhe jashtë territorit të bashkisë.

Gjatë vitit 2017 janë futur në skemën e ndihmës ekonomike, me status viktimë e dhunës në familje, 4 (katër) gra të mbijetuara . 5 (pesë) fëmijë të mbijetuar të dhunës në familje janë përjashtuar nga tarifa mujore e çerdhes dhe kopshtit publik. 10 (Dhjetë) fëmijë kanë marrë libra shkollorë dhe materiale të tjera falas. Nga Bonusi i Strehimit kanë përfituar 2 gra dhe fëmijët e tyre si të mbijetuar të dhunës në familje. Bonusi i Strehimit konsiston në rimbursimin e qerasë në masën 50% -100% për një vit me të drejtë shtyrjeje bazuar në kushtet e përfituesit.

Gjatë vitit 2017 Bashkia Korçë ka menaxhuar dy raste, të cilat nuk kanë qënë qytetare të Korçës, por të ndodhura në territorin e saj. Rasti K.H është referuar nga Bashkia Devoll. Zonja është sistemuar në strehëz për një afat një mujor. Ajo shfaqte probleme të shëndetit mendor dhe ishte vështirë për ta menaxhuar. K.H është shoqëruar disa herë në mjeku psikiatër, por nuk pranonte të merrte barnat. Pas akoordimit të UM nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, MKR e Devollit ka vendosur sistemimin e saj në strehëzën Kombëtare në Kamëz, për një afat më të gjatë kohor. Rasti F. H qytetare e Bashkisë së Pogradecit, është menaxhuar edhe gjatë muajit Janar 2018 nga MKR Korçë. Ky ishte rast shumë i vështirë.

Tabela 7. Numri i mbledhjeve të Grupi Teknik Ndërdisciplinor sipas viteve

Viti	Mbledhjet e GTN
2014	4
2015	4
2016	4
2017	4

Burimi: Bashkia Korçë

Tabela 8. Numri i mbledhjeve të Komitetit Drejtues sipas viteve

Viti	Mbledhjet e KD
2014	1
2015	1
2016	1
2017	1

Burimi: Bashkia Korçë

Tabela 9. Koordinator vendor kundër Dhunës me bazë Gjinore DhBGj

Viti	Koordinatori Vendor kundër DhBGj
2014	Elizeta Bita
2015	Elizeta Bita
2016	Elizeta Bita
2017	Elizeta Bita

Burimi: Bashkia Korçë

Tabela 10. Grupi Teknik Ndërdisciplinor e Bashkisë Korçë

Institucioni	Emër mbiemer i përfaqësuesit në vitin 2017
Bashkia	Elizeta Bita
Drejtoria e Policisë	Dhurata Mehmeti
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Esmerald Xhafa
Prokuroria e Rrethit	Olga Visi
Drejtoria Arsimore Rajonale	Jorgjeta Babliku/Doriana Balli
Drejtoria e Shëndetit Publik	Elisabeta Dino
Zyra e Përmbarimit	Olta shkëmbi

Prefektura	-
Kryetarët e Njësive Administrative	7 administratoret shoqerore te NJ.A
Zyra e Punësimit	Helena Zhappa
Organizata Jo qeveritare	Erjon Jonusllari
Strehezat për viktimat e dhunës	Daniela Drabo
Komunitete fetare	Nuk ka
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Nuk ka

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara

Sipas të dhënave statistikore për vitin 2017 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë janë regjistruar gjithsej 118 çështje penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës. Më tej janë ndjekur 7 çështje penale të dhunës në familje, prej të cilave 4 të mbartura nga vitet e kaluara dhe 3 të reja gjatë vitit 2017. Statistikat nuk përmbajnë të dhëna për dënimet e propozuara për këto raste.³ Gjithashtu të dhënat nuk ndahen sipas gjinisë së viktimës dhe autorit të veprës penale, çka e bën të vështirë analizimin e situatës të dhunës me bazë gjinore. Mbajtja më e detajuar dhe e saktë e të dhënave, e disagreguar sipas gjinisë, sikurse bëhet tashmë në nivel kombëtar është e domosdoshme për:

- 1- Krijimin e një panorame të saktë e të detajuar të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Bashkinë e Korcës.
- 2- Përdorimin e statistikave për të hartuar programe ndërhyrjeje në nivel bashkie, që ndihmon në hartimin dhe implementimin e politikave bazuar në fakte dhe evidenca.

Sa i përket përmirësimit të shërbimit të provës vlen të theksohet se pavarësisht publikimit të statistikave online, si mujore ashtu edhe vjetore, në rang kombëtar dhe rajonal, këto të dhëna nuk ndahen sipas llojit të veprës penale, gjinisë si edhe llojit të dënimit alternativ të kryer. Kjo e pengon krijimin e një panorame të saktë për dënimet alternative dhe përpjekjet rehabilituese të autorëve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Aktualisht shërbimi i provës në bashkinë e Korcës ka mangësi në staf, duke punësuar vetëm drejtorin e shërbimit të provës. Kjo e vështirëson monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave si edhe vlerësimin e përpjekjeve për përmirësimin e rolit të shërbimit të provës në identifikimin e nevojave për referimin e rasteve konkrete të dhunuesve në varësi të formës së dhunës së suhtruar e në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas objektivit 3.3.6.

Tabela 11. Dhunuesit në sistemin gjyqësor Korçë

Vitet	Nr. i dhunuesve
2014	
2015	
2016	
2017	

Burimi: Gjykata Korçë

³ Të dhënat janë marrë nga <http://ëëë.gjykata.gov.al/rrethi-korc%C3%AB/gjykata-e-rrethit-korc%C3%AB/statistika/c%C3%ABshtjet-penale/>

Rekomandime në bazë të monitorimit të punës kundër dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Korçë

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Korçës, më poshtë renditen disa rekomandime për përmirësimin e punës së funksionimit të Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Korçë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ (2016-2020), kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Rekomandohet që përgjatë vitit kalendarik 2018 të kryhet zgjerimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje në partneritet me të gjithë aktorët vendorë kundër dhunës në familje. Bashkia Korçë duhet të gjejë mundësi financiare të mbulojë shërbim psikologjik falas për viktimat e dhunës në familje si dhe konsulencë juridike falas për çdo rast.
- Bashkia Korçë duhet të marrë masa dhe ofrojë shërbim për rehabilitimin e dhunuesve. Kjo sfidë që gjendet edhe në nivel kombëtar sipas monitorimit të QAGJZh dhe raporteve të ndryshme ndërkombëtare rekomandohet të adresohet në nivel kombëtar dhe vendor në mënyrë që të krijohen mekanizmat e duhura për rehabilitimin e dhunuesve.
- Bashkia Korçë duhet të dedikojë financim për mbulimin e shërbimit psiko-social dhe ndihmës së drejtpërdrejtë për përfituesit.
- Çdo institucion pjesë e mekanizmit kundër dhunës duhet të zbatojë detyrat përkatëse që rrjedhin nga Ligji për Masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare apo nga konventat ndërkombëtare. Për të rritur përgjegjësitë e institucioneve përkatëse është e nevojshme të përmirësohet baza ligjore duke përcaktuar detyrime për çdo institucion i përfshirë në VKM nr.334, datë 17.2.2011, Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij si dhe të zbatohen detyrimet përkatëse që rrjedhin.
- Të forcohet zbatimi i ligjit që në rastet e lëshimit të UMM/UM, në vendim të shprehet qartë largimi i dhunuesit dhe jo i të dhunuarës bashkë me fëmijët.
- Shërbimi i provës duhet të ofrojë të dhëna më të detajuara dhe të ketë bashkëpunim më aktiv me bashkinë për referimin e rasteve të dënimeve alternative dhe rintegrimim e personave të dënuar.
- Bashkia Korçë duhet të mbledhë dhe përdorë statistika dhe të dhëna sasiore në nivel bashkie që të jenë sa më të detajuara dhe të ndara sipas gjinisë. Përdorimi i këtyre statistikave do të ndihmonte procesin e hartimit të politikave dhe planeve lokale bazuar në evidenca.
- Pavarësisht bashkëpunimit të vazhdueshëm më organizatat e shoqërisë civile në nivel lokal, qëndrueshmëria e këtij bashkëpunimi është e diskutueshme dhe e varur nga shumë faktorë. Mungesa e bashkëpunimit do të ndikonte negativisht në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, ndaj rekomandohet që bashkia Korçë të rrisë buxhetin për të mbuluar shërbime sociale dhe juridike për viktimat e dhunës në familje, përmes organizatave lokale aktive në luftën kundër dhunës ndaj grave.
- Qeveria duhet të alokojë fonde të posaçme për zbatimin e SKBGJ në nivel lokal. Kjo e vendos barrën e zbatimit të strategjisë kryesisht tek burimet ekzistuese në nivel lokal.
- Më tepër burime financiare dhe njerëzore duhen investuar për ofrimin e shërbimeve mbështetëse, vecanërisht për kategori të marginalizuara, si për shembull persona me aftësi të kufizuara, personat LGBTI etj.

- Masa e ndihmës ekonomike si edhe strehimi për gratë dhe vajzat e dhunuara dhe kryefamiljare është shpesh e pamjaftueshme për sigurimin e pavarësisë së tyre ekonomike. Për rrjedhojë rritja e masës së ndihmës ekonomike do të ishte me vlerë.
- Ndryshe nga bashkitë e tjera në Korçë vërehet bashkëpunim me organizatat fetare të cilat janë mjaft aktive në këtë bashki dhe ofrojnë mjaft shërbime, shpesh duke qenë në kontakt e duke bashkëpunuar me stafin e bashkisë. Megjithatë, më tepër përpjekje duhen bërë për koordinimin e strategjive ndërhyrëse, për përdorimin më efikas të shtrirjes së këtre organizatave në territorin e bashkisë për të krijuar një front të përbashkët.
- Duhet të rriten kapacitetet e të gjithë përfaqësuesve të GTN si pjesë e MKR si dhe të rritet prezenca e tyre në takimet e GTN-së dhe përgjigjshmëria sipas rastit.
- Megjithëse streha e emergjencës ka qenë funksionale përgjatë vitit 2017 bashkia duhet të marrë masa për ofrimin e shërbimeve të specializuara në këtë qendër të cilat gjatë 2017 jan ëmundësuar me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile.
- Shërbimi i provës duhet të ofrojë të dhëna më të detajuara dhe të ketë bashkëpunim më aktiv me bashkinë për referimin e rasteve të dënimeve alternative dhe rintegrimin e personave të dënuar.
- Mbledhja dhe përdorimi i statistikave dhe të dhënave sasiore në nivel bashkie, sa më të detajuara dhe të ndara sipas gjinisë mbetet sfidë për bashkinë. Përdorimi i këtyre statistikave do të ndihmonte procesin e hartimit të politikave dhe planeve lokale bazuar në evidenca.
- Më tepër burime financiare dhe njerëzore duhen investuar për ofrimin e shërbimeve mbështetëse, vecanërisht për kategori të marginalizuara, si për shembull persona me aftësi të kufizuara, personat LGBTI etj.